



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2699/6 prot.

Datë 11.12.2023

V E N D I M
Nr. 1279/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.12.2023 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Anulimin e procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar – shërbime , nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me një ose më shumë operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF- 81675-09-28-2023, me objekt: “Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore”, Loti I: REF-81681-09-28-2023 me objekt Loti I : “Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore” (për landfillin) me fond limit 3.000.000 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 10.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria “ECO – ELB” SHA.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GR Albania” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues: Operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK, me NIPT K92402036A, me adresë: Zona Kadastrale 2679, Hyrja 2, Ap.39, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria “ECO – ELB” SHA, me adresë: Lagjja “Brigada 17 Sulmuese”, Bulevardi “Qemal Stafa”, Elbasan.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, me NIPT L51512009E, me adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Irfan Tomini”, Pallati nr.50, Kati I - rë, Tiranë

Operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK, me NIPT L81904506I, me adresë: Rruga dytësore “Maminas – Sukth”, Km.2, Durrës

Operatori ekonomik “GR Albania” SHPK, me NIPT L01509004N, me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Ndërtesa Nr. 19, Hyrja Nr. 8, Kodi Postar 1019, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:
I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.09.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar – shërbime , nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me një ose më shumë operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF- 81675-09-28-2023, me objekt: “Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore”, Loti I: REF-81681-09-28-2023 me objekt Loti I : “Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore” (për landfillin) me fond limit 3.000.000 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 10.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria “ECO – ELB” SHA.

II.2. Në datën 10.10.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 27.10.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK	1,804,000.00	kualifikuar
2. “Tenuis Laboratories” SHPK	1,890,000.00	kualifikuar
3. “GR Albania” SHPK	2,408,000.00	kualifikuar
4. “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK	2,688,000.00	kualifikuar

II.4. Në datën 30.10.2023, në Sistemin e Prokurimit Elektronik është publikuar Njoftimi i Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 06.11.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3562, protokolluar me nr. 2699 prot., datë 06.11.2023, e operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK, i cili kërkon anulimin e procedurës së prokurimit, si dhe kundërshton kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, “Tenuis Laboratories” SHPK dhe “GR Albania” SHPK.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2699/2 prot., datë 07.11.2023, duke publikuar kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK dhe “Tenuis Laboratories” SHPK dhe “GR Albania” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.5.2. Me anë të shkresës Nr. 744 prot., datë 10.11.2023, protokolluar me tonë me nr. 2699/3 prot., datë 13.11.2023, me objekt “Vendim i autoritetit kontraktor për ankesën e OE të paraqitur pranë KPP”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendim mbi shqyrtimin e ankesës së ankimuesit “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK, ku konstatohet, se ankesa e këtij të fundit është refuzuar si vijon:

“[...]

Lidhur me këtë kërkesë të operatorit ekonomik " Qendra e Monitorimit të Mjedisit"

*duam të sqarojmë se vendosja e urdhrit nr. 77 dt. 02.07.2020 në vend të urdhrit nr. 126 date. 10.06.2022 ka qenë një **gabim njerëzor** dhe se në arsyetimin e nevojës për shërbim është vendosur urdhri nr. 126 datë 10.06.2022.*

1. *Në lidhje me kërkesën nr. 2 të operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “ ECCAT” Environmental Consulting Chemical Analysis & Testing, duam të sqarojmë se:*

- *Oferta e dhënë nga Operatori Ekonomik " Eccat" sh.p.k sipas përlllogaritjes së mesatares së ofertave të vlefshme, rezulton si anomalisht e ulët, dhe duke u bazuar në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK” Neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 4:*

- *Ne rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre në përputhje me nenin 93, të LPP-së. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementët e veçanta të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

Autoriteti Kontraktor "Eco- Elb" sha i ka kërkuar sqarime operatorit ekonomik "Eccat ShPK" kërkesë se cilës operatori ekonomik "Eccat sh.p.k" i është përgjigjur duke argumentuar bazuar në dokumentim arsyet se përse ka vendosur të japë atë vlerë si oferte. Pasi u shqyrtua argumentimi i operatorit ekonomik, autoriteti kontraktor e gjykoi si bindes dhe e pranoi shpjegimin e dhënë nga operatori ekonomik "Eccat" ShPK.

- *Përsa i perket kërkesës se operatorit "Qendra e Monitorimit të Mjedisit" mbi certifikatën e akreditimit të operatorit ekonomik "Eccat" sh.p.k të publikuar në Drejtorinë e Pergjithshme të Akreditimit (DPA) dhe kërkesave të cituara në shtojcën nr.5 të Dst, ku pretendohet se operatorit ekonomik "Eccat" sh.p.k i mungojnë parametrat:*
 - *Për matricën ujë: Temperatura, Toksiciteti, Nitrat Amoni Rrjedha maksimale Rrjedha ditore, fenole volatile*
 - *Per matricën ajer (nga burime pikesore) PM10, NOx*

Duam të sqarojmë se në kërkesat e dst pikat 2.3.2 dhe 2.3.7 autoriteti kontraktor "Eco Elb" sh.a ka kërkuar:

2.3.2 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi laborator të akredituar sipas standardit S SH ISO IEC 17025:2017, për fushat: analiza ujërash (ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore), niveli i zhurme, cilësia e ajrit (gaze dhe grimcat).

2.3.7 Operatori Ekonomik, duhet të vërtetojë se posedon të paktën 1 (një) pajisje laboratorike, për të bërë të mundur matjen e cdo parametri të listuar.

Sic shihet qartë autoriteti kontraktor ka kërkuar një laborator të akredituar sipas standardit S SH ISO IEC 17025:2017 dhe jo që çdo parametër të jetë i akredituar sipas standardit S SH ISO IEC 17025:2017.

Përsa i përket pretendimit se operatori ekonomik "Eccat" sh.p.k nuk përmbush pikën 2.3.8 të dst ku citohet se:

2.3.8 Operatori Ekonomik, të ketë të paktën përvojë pune 2 (dy) vjeçare në fushën objekt i kësaj gare, duke plotësuar kriteret kualifikuese për këtë periudhë.

Referuar ekstraktit historik të operatorit ekonomik vihet re se data e regjistrimit të subjektit është 10/03/2015 dhe së objekti i veprimtarisë është si më poshtë:

Konsulenca mjedisore, përgatitje e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), auditime mjedisore, përgatitje raportesh vetmonitorimi sipas kushteve të lejeve mjedisore, laborator analizash kimike dhe mjedisore, konsulenca dhe asistime për shendetin dhe sigurinë në punë, asistencë për përputhshmerinë me legjislacionin në fuqi për mjedisin, cilesinë dhe shendetin e sigurinë në punë. Import-Export, Konsulencë Ekonomike, Juridike, Marketing dhe Logjistike. Aktivitete turistike dhe hotelieri. Shërbime të analizave mikrobiologjike dhe biokimike për fushat e prodhimit mjedisor, farmaceutik dhe sigurisë ushqimore. Import - Eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të kimikateve të ndryshme, terrenesh, instrumentesh, aparaturash, mobilje dhe pajisje elektronike në fushën laboratorike dhe industri të tjera. Shërbime kërkimore dhe zhvillimore në fushën mjedisore, sigurisë ushqimore, kozmetike dhe farmaceutike. Trajnime profesionale për llogari të vet dhe për llogari të treta. Shërbime në fushën e kalibrimeve të pajisjeve laboratorike dhe të industrive të tjera.

Siç shihet qartë si nga data e regjistrimit, objekti i veprimtarisë por referuar edhe faturave tatimore të ngarkuara në sistem në përmbushje të pikës 2.3.1 të DST si punë të ngjashme, dalim në konkluzionin se pretendimet e operatorit ekonomik " Qendra e Monitorimit të Mjedisit" për skualifikim të operatorit ekonomik "Eccat" sh.p.k janë të pabazuara në fakte.

2. Për sa i përket kërkesës së operatorit "Qendra e Monitorimit të Mjedisit" mbi certifikatën e akreditimit të operatorit ekonomik "Tenuis Laboratories" sh.p.k të publikuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) dhe kërkesave të cituara në shtojcën nr.5 të Dst, ku pretendohet se operatorit ekonomik "Tenuis Laboratories" sh.p.k i mungojnë parametrat:

- Për matricën ujë: Temperatura, Toksiciteti, Nitrat Amoni, Rrjedha maksimale. Rrjedha ditore, fenole volatile
- Për matricën ajër (nga burime pikësore) PM10, NOx

Duam të sqarojmë se në kërkesat e dst pikat 2.3.2 dhe 2.3.7 autoriteti kontraktor "Eco Elb" sh.a ka kërkuar :

2.3.2 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi laborator të akredituar sipas standardit S SH ISO IEC 17025:2017, për fushat : analiza ujërash (ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore), niveli i zhurme, cilësia e ajrit (gaze dhe grimcat).

2.3.7 Operatori Ekonomik, duhet të vërtetojë se posedon të paktën 1 (një) pajisje laboratorike, për të bërë të mundur matjen e çdo parametri të listuar.

Siç shihet qartë autoriteti kontraktor ka kërkuar një laborator të akredituar sipas standardit S SH ISO IEC 17025:2017 dhe jo që çdo parametër të jetë i akredituar sipas standardit S SH ISO IEC 17025:2017.

Përsa i përket pretendimit se operatori ekonomik "Tenuis Laboratories" sh.p.k nuk përmbush pikën 2.3.8 të dst ku citohet se:

2.3.8 Operatori Ekonomik, të ketë të paktën përvojë pune 2 (dy) vjeçare në fushën objekt i kësaj gare, duke plotësuar kriteret kualifikuese për këtë periudhë.

Referuar ekstraktit historik të operatorit ekonomik vihet re se data e regjistrimit të subjektit është 04/07/2018 dhe se objekti i veprimtarisë është si me poshte:

Sherbime te analizave mikrobiologjike, fiziko-kimike dhe biokimike per fushat e prodhimit farmaceutik, sigurisë ushqimore dhe mjedisit. Shërbime kontrolli cilësie, shërbime kërkimore dhe zhvillimore ne fushat farmaceutikë, biologjike dhe bioteknologjike industrisë kimike, mjekësore dhe çdo aktivitet tjetër te lejuar me lig). Import-Eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice te kimi kateve te ndryshme, terrenesh, instrumentesh, aparaturash, mobile dhe pajisje kompjuterike per laboratore dhe industri te ndryshme. Monitorime te gjendjes se mjedisit, konsulenca mjedisore, përgatitje e raporteve te vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM), auditime mjedisore, pergatitje raportesh vetmonitorimi sipas kushteve te lejeve mjedisore. Konsulence dhe asistence per shendetin dhe sigurine ne pune, perputhshmerine me legjislacionin ne fugi per mjedisin, shendetin dhe sigurine ne pune Organizon trajnime profesionale per llogari te vet dhe/ ose per llogari te treteve. Me qellim realizimin e objektit te aktivitetit te saj, shoqeria mund te kryeje çdo veprimtari te nevojshme e te dobishme, te lejuar nga ligji. Kompania mund te lidhe marreveshje bashkepunimi me ente te tjera private ose publike si dhe mund te aplikojë dhe aksesojë fonde publike.

Siç shihet qartë si nga data e regjistrimit, objekti i veprimtarisë por referuar edhe faturave tatimore të ngarkuara në sistem në përmbushje të pikës 2.3.1 te dst si punë të ngjashme, dalim ne konkluzionin se pretendimet e operatorit ekonomik " Qendra e Monitorimit të Mjedisit" per skualifikim e operatorit ekonomik "Tenuis Laboratories " sh.p.k janë të pabazuara ne fakte.

3. Për sa i përket kërkesës së operatorit "Qendra e Monitorimit të Mjedisit" mbi certifikatën e akreditimit të operatorit ekonomik "GR Albania" sh.p.k të publikuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) dhe kërkesave të cituara në shtojcën nr.5 të Dst, ku pretendohet se operatorit ekonomik "Tenuis Laboratories" sh.p.k i mungojnë parametrat.

- Për matricën ujë : Temperatura, Toksiciteti, Nitrati Amoni, Rrjedha maksimale. Rrjedha ditore, fenole volatile*
- Për matricën ajër (nga burime pikësore) PM10, NOx*

Duam të sqarojmë se në kërkesat e dst pikat 2.3.2 dhe 2.3.7 autoriteti kontraktor "Eco Elb" sh.a ka kërkuar:

2.3.2 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi laborator të akredituar sipas standardit S SH ISO IEC 17025:2017, për fushat : analiza ujërash (ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore), niveli i zhurme, cilësia e ajrit (gaze dhe grimcat).

2.3.7 Operatori Ekonomik, duhet të vërtetojë se posedon të paktën 1 (një) pajisje laboratorike, për të bërë të mundur matjen e çdo parametri te listuar.

Siç shihet qartë autoriteti kontraktor ka kërkuar një laborator të akredituar sipas standardit S SH ISO IEC 17025:2017 dhe jo që çdo parametër të jetë i akredituar sipas standardit S SH ISO IEC 17025:2017.

Përsa i përket pretendimit se operatori ekonomik "GR Albania" ShPK nuk përmbush pikën 2.3.8 të dst ku citohet se:

2.3.8 Operatori ekonomik të ketë të paktën përvojë pune 2 9dy) vjeçare në fushën objekt i kësaj gare, duke plotësuar kriteret kualifikuese për këtë periudhë. Referuar ekstraktit historik të operatorit ekonomik vihet re se data e regjistrimit të subjektit është 09.03.2010 dhe se objekti i veprimtarisë është si më poshtë.....

Siç shihet qartë si nga data e regjistrimit, objekti i veprimtarisë por referuar edhe faturave tatimore të ngarkuara në sistem në përmbushje të pikës 2.3.1 të dst si punë të ngjashme, dalim në konkluzionin se pretendimet e operatorit ekonomik "Qendra e Monitorimit të Mjedisit" për skualifikimin e operatorit ekonomik "GR Albania" SHPK janë të pabazuara në fakte.

Në përfundim të shqyrtimit Komisioni:

Vendosi:

- 1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Qendra e Monitorimit të Mjedisit" duke hedhur poshtë të gjitha pretendimet e ngritura se Komisioni i Vlerësimit të ofertave nuk ka bërë një gjykim të drejtë në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës [...]"***

II.6 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK me arsyetimin se : “Në shtojcën 5 të DST formulari i specifikimeve teknike kërkohet të kryhen raportimet sipas urdhrin nr. 77 datë 02.07.2020 për procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumenteve dhe raporteve të vetëmonitorimit.....urdhëri nr. 77 datë 02.07.2020 është shfuqizuar me daljen e urdhrin nr. 126 datë 10.06.2022 “Për procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumenteve dhe raporteve të vetëmonitorimit, për subjektet e pajisur me leje mjedisi të tipit A ose B. Pra autoriteti kontraktor i është referuar për kryerjen e specifikimeve teknike një baze ligjore të shfuqizuar.

Nga ana tjetër në listën e dokumenteve të dorëzuara gjithashtu mungon kërkesa për dokumentin nr. 17 plani i mostrimit (për vitin aktual ushtrimor, për secilin 3 mujor apo 6 mujor raportimi) kushti 12 i lejes mjedisore e cila është kërkesë e urdhrin nr. 126 datë 10.06.2022 “Për procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumenteve dhe raporteve të vetë monitorimit, për subjektet e pajisur me leje mjedisi të tipit A ose B” gjë e cila tregon edhe njëherë se autoriteti i është referuar një baze ligjore të shfuqizuar [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Në dokumentet e tenderit në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Specifikimet teknike në lidhje me Landfillin.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Objektivat e këtij vlerësimi janë:

- të pasqyrojë emisionet e lëngeta, cilësinë e tyre dhe ndikimin e tyre në ujrat pritëse;
- të pasqyrojë nivelin e grimcave të ngurta pezull në ajër;
- të pasqyrojë nivelin e zhurmës së aktivitetit dhe edikimit në popullatën lokale;
- të pasqyrojë nivelin e gazeve të emetuar në ajër;
- të kryjë një vëzhgim të përgjithshëm mbi ndotjen dhe ndikimet evidente në mjedisin përreth zones së aktivitetit;
- të nxjerrë rezultate në lidhje me performancën e përgjithshme mjedisore të aktivitetit;
- të japë rekomandime për përmirësime të mundshme teknologjike dhe menaxhimi që mund të sjellin ulje të ndikimit në mjedis.

2. Në tabelat e mëposhtme paraqiten parametrat që do të monitorohen për landfillin dhe impiantin sipas Kushti 7-Shkarkimet, Kushti 9-Zhurmat dhe vibracionet, Kushti 11-Monitorimi dhe sipas Shtojcave në lejet mjedisore mjedisore përkatëse me PN-1423-12-2015 dhe PN-5783-09-2017

Specifikimet teknike në lidhje me landfillin.

Parametrat e ujit që do të analizohen.

Nr.	Parametri mjedisor që monitorohet	Vendi i mostrimit
1	ph	Ujra sipërfaqesore, Shkarkim në kanalizime
2	Temperatura	Ujra sipërfaqesore, Shkarkim në kanalizime
3	DO	Ujra sipërfaqesore, Shkarkim në kanalizime
4	BOD5	Ujra sipërfaqesore, Shkarkim në kanalizime
5	COD	Ujra sipërfaqesore, Shkarkim në kanalizime
6	N-NH4	Ujra sipërfaqesore, Shkarkim në kanalizime
7	Rrjedhja ditore	Ujra sipërfaqesore, Shkarkim në kanalizime
8	Rrjedhja maksimale	Ujra sipërfaqesore, Shkarkim në kanalizime
9	Perberesit organike të fosforit	Ujra sipërfaqesore
10	P total	Ujra sipërfaqesore, Shkarkim në kanalizime
11	Lende pezull	Shkarkim në kanalizime
12	N-total	Shkarkim në kanalizime
13	P-total	Shkarkim në kanalizime
14	TSS	Puset piezometrik
15	PH	Puset piezometrik
16	Turbiditeti	Puset piezometrik
17	Lendet pezull	Puset piezometrik

18	<i>Konduktiviteti elektrik</i>	<i>Puset piezometrik</i>
19	<i>Oksigjeni i tretur</i>	<i>Puset piezometrik</i>
20	<i>BOD5</i>	<i>Puset piezometrik</i>
21	<i>COD</i>	<i>Puset piezometrik</i>
22	<i>DO</i>	<i>Puset piezometrik</i>
23	<i>Amonia N/NH3/NH4</i>	<i>Puset piezometrik</i>
24	<i>Azot Total</i>	<i>Puset piezometrik</i>
25	<i>Fosfor Total</i>	<i>Puset piezometrik</i>
26	<i>Perberesit organike te fosforit</i>	<i>Puset piezometrik</i>
27	<i>Cl-</i>	<i>Puset piezometrik</i>
28	<i>Arseniku</i>	<i>Puset piezometrik</i>
29	<i>Bakri</i>	<i>Puset piezometrik</i>
30	<i>Plumbi</i>	<i>Puset piezometrik</i>
31	<i>Nikeli</i>	<i>Puset piezometrik</i>
32	<i>Kromi VI</i>	<i>Puset piezometrik</i>
33	<i>Zinku</i>	<i>Puset piezometrik</i>
34	<i>Hekur</i>	<i>Puset piezometrik</i>
35	<i>Koliform total</i>	<i>Puset piezometrik</i>

Parametrat e ajrit qe do te analizohen.

Nr.	Parametri mjedisor qe monitorohet	Vendi i mostrimit
1	<i>Grimca te ngurta ne ajer</i>	<i>Ajer</i>
2	<i>LNP mes</i>	<i>Ajer</i>
3	<i>LNP max</i>	<i>Ajer</i>
4	<i>PM10</i>	<i>Ajer</i>
5	<i>CO</i>	<i>Ajer</i>
6	<i>NO2</i>	<i>Ajer</i>
7	<i>O2</i>	<i>Ajer</i>
8	<i>SO2</i>	<i>Ajer</i>
9	<i>CXHY</i>	<i>Ajer</i>
10	<i>VOC*</i>	<i>Ajer</i>
11	<i>Niveli i zhurmes ne mjedis per parametrat Laeq, Lamax</i>	<i>Sipas pikave te percaktuara ne leje mjedisore</i>

Specifikimet teknike në lidhje me impiantin.

Parametrat e ujit qe do te analizohen.

Nr.	Parametri	Vendi i mostrimit
1	<i>pH</i>	<i>Shkarkim ne kanalizime, Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
2	<i>Rrjedhja ditore m³, Niveli max i rrjedhjes m³/ore</i>	<i>Shkarkim ne kanalizime, Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
3	<i>Temperatura</i>	<i>Shkarkim ne kanalizime Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
4	<i>Lëndët në pezulli</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
5	<i>Nevoja biokimike për oksigjen, (BOD5)</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
6	<i>Nevoja kimike per oksigjen, COD</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
7	<i>Nitrati total (N-NO3-)</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>

8	<i>Nitrat Amoni</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
9	<i>Fenolet volatile</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
10	<i>Benzeni</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
11	<i>Toksiciteti</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
12	<i>Oksigjeni i tretur, DO</i>	<i>Shkarkim kanalizime</i>
13	<i>Përbërësit organikë të fosforit (P-org)</i>	<i>Shkarkim kanalizime</i>
14	<i>Percjellshmeria elektrike</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
15	<i>Azot amoniaku N</i>	<i>Shkarkim ne kanalizime</i>

Parametrat e ajrit qe do te analizohen.

Nr.	Parametri	Vendi i mostrimit
1	<i>SO2</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
2	<i>NO2</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
3	<i>NOx</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
4	<i>O2</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
5	<i>CO</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
6	<i>CxHx</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
7	<i>Lenda e ngurte totale</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
8	<i>HCL</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
9	<i>HF</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
10	<i>TM</i> <i>(Sb+As+Pb+Cr+Co+Cu+Mn+Ni+V)</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
11	<i>Cd & TL</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
12	<i>Hg</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
13	<i>PCDD/PCDF</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
14	<i>Temperatura, Presioni</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
15	<i>SHpejtesia</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
15	<i>Grimca</i>	<i>Ajri I ambientit</i>
16	<i>PM10</i>	<i>Ajri I ambientit</i>
17	<i>Zhurmat ne ambient</i>	<i>Ne 8 pika (sipas percaktimeve ne lejen mjedisore)</i>

RAPORTIMET Sipas urdherit nr.77

*Bazuar ne Urdhrin me Nr 77 date 02.07.2020 Per proceduren e dorezimit/pranimit te dokumentave dhe raporteve te vetemonitorimit, **dokumentat per Zbatimin e Kushteve Vjetore***

Nr.	Kushti i lejes Mjedisore	Emertimi i Dokumentit
1	2	<i>Dokumentacioni lidhur me menaxhimin e perberesve te mjedisit per instalimin/impiantin</i>
2	2.9.2	<i>Programi i menaxhimit te mjedisit</i>
3	2.9.2	<i>Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotjes – Raporti per vitin paraardhes</i>
4	2.9.2	<i>Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotjes – Propozim per vitin aktual</i>
5	2.9.2	<i>Raport permbledhes mbi rezultatet e monitorimit te zhurmes</i>
6	2.9.2	<i>Pershkrimi i monitorimit te mjedisit</i>
7	2.9.2	<i>Pershkrimi i Incidenteve/Aksidenteve</i>
8	2.9.2	<i>Raport permbledhes per Auditimin e Eficences se Energjise</i>
9	2.9.2	<i>Raport per vleresimin e eficences se shfrytezimit te lendeve te para dhe reduktimin e gjenerimit te mbetjeve</i>
10	2.9.2	<i>Menaxhimi i mbetjeve</i>
11	2.9.2	<i>Raport Permbledhes per Auditimin e Eficences se Ujit</i>

12	2.9.2	Deklarate mbi masat per parandalimin e ndotjes se mjedisit dhe veprimet e rehabilitimit
13	2.9.2	Program i Menaxhimit te Riskut
14	2.9.2	Plan i Perputhshmerise
15	2.9.2	Plani i cmontimit ose rehabilitimit
16	10	Lendet e para dhe shfrytezimi I energjise
17	12	Dokumentimi dhe Raportimi
18		Raport mbi ankesat
19	13	Incidentet dhe veprimet gjate emergjencave
20	14	Cmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas nderprerjes se operacioneve
21		Raporti Vjetor i Monitorimit

Bazuar ne Urdhrin me Nr 77 date 02.07.2020 Per proceduren e dorezimit/pranimit te dokumentave dhe raporteve te vetemonitorimit, **dokumentat per Zbatimin e Kushteve 3**

Mujore

Kushti i lejes Mjedisore	Zbatimi i kushteve periodike 3 mujore
1.6	Vendndodhja e ushtrimit te veprimtarise
6	Njoftimet
7	Shkarkimet
7	Plani i menaxhimit te tretesave organike
7	InspektimeVizualeDitore/Javore/Mujore per instalimet dhe shkarkimet ne ajer, uje, toke, zhurme, mbetje.
7	Mirembajtja/Plani i Sherbimeve
8	Menaxhimi i mbetjeve
8	Plani i Menaxhimit te mbetjeve
9	Zhurmat dhe Vibracionet
11	Monitorimi
12	Dokumentimi dhe Raportimi
12	Raporti Periodik i Monitorimit

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.3. Në nenin 36, pikat 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, dhe se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, si dhe specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se përcaktimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë kriteret në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se kërkesat për kualifikim përcaktohen në mënyrë të tillë që një kandidat të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësinë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

III.1.5. Nisur nga objekti i kontratës objekt - prokurimi “Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore (për landfillin)”, si dhe nga shqyrtimi i shtojcës 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, rezulton se objektivat e këtij vlerësimi janë: “të pasqyrojë emisionet e lëngëta, cilësinë e tyre dhe ndikimin e tyre në ujrat pritëse; të pasqyrojë nivelin e grimcave të ngurta pezull në ajër; të pasqyrojë nivelin e zhurmës së aktivitetit dhe ndikimit në popullatën lokale; të pasqyrojë nivelin e gazeve të emetuar në ajër; të kryjë një vëzhgim të përgjithshëm mbi ndotjen dhe ndikimet evidente në mjedisin përreth zones së aktivitetit; të nxjerrë rezultate në lidhje me performancën e përgjithshme mjedisore të aktivitetit. Ndërsa referuar shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit “Termet e Referencës”, qëllimi i këtij raporti monitorimi është të “pasqyrojë situatën reale të performancës mjedisore të landfill-it të Elbasanit dhe të paraqesë ndikimet që ky objekt ka në mjedisin përreth në

përputhje me kërkesat ligjore. Është e rëndësishme që të dhënat e prodhuara të jenë përfaqësuese, të domosdoshme, të vlefshme dhe që lejojnë vlerësimin e saktë të ndikimit të deponisë në mjediset. Qëllimi i programit të monitorimit fillimisht duhet të identifikohet nga procesi i hetimit, vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe natyra e mbetjeve që depozitohen. Ai duhet të përfshijë të gjitha fushat mjedisore që mund të ndikohen ndjeshëm përmes funksionimit të landfillit. Monitorimi i ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor, duke përfshirë biocilësinë dhe analizimin e parametrave kryesore, Monitorimi i ajrit dhe shqyrtimi i niveleve të ndotjes në zonë duke identifikuar parametrat që janë në nivele problemetike, Monitorimi i ndotjes akustike ka për qëllim vlerësimin e nivelit të ndotjes akustike në pikat kryesore të zonës, për të dhënë mundësinë që të gjykohet mbi nivelin e zhurmës së emetuar“. Nga shqyrtimi i shtojcës 5 “Specifikimet teknike”, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar që raportimet do të bëhen sipas urdhrit nr. 77, datë 02.07.2020 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, ndërkohë në shkresën nr. 744 prot., datë 10.11.2023, autoriteti kontraktor citon se “ [...]*vendosja e urdhrit nr. 77 dt. 02.07.2020 në vend të urdhrit nr. 126 datë 10.06.2022 ka qënë një gabim njerëzor dhe se në arsyetimin e nevojës për shërbim është vendosur urdhri nr. 126 datë 10.06.2022*”. Referuar Urdhrit nr. 126, datë 10.06.2022 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, “Për procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumenteve dhe raporteve të vetëmonitorimit, për subjektet e pajisur me leje mjedisi të tipit A ose B”, operatorët e pajisur me leje mjedisi të tipit A ose B, dorëzojnë dokumentat dhe raportet vetëmonitorimit mbi zbatimin e kushteve të lejes vjetore, ku lista e dokumentacioneve që dorëzohet nga operatorët e pajisur me leje mjedisore të tipit A ose B përcaktohet në aneksin 1 bashkëlidhur urdhrit, në të cilin rezulton se përcaktohen dokumentat që dorëzohen në zbatim të kushteve që plotësohen vetëm një herë (3 mujori i parë i lejes), dokumentet që dorëzohen në zbatim të kushteve periodike 3 ose 6 mujore, dokumentat që dorëzohen në zbatim të kushteve vjetore. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit shtojcës 5 “Formulari i specifikimeve teknike” dhe urdhrit nr. 126, datë 10.06.2022 i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit rezulton se në dokumentet e tenderit mungon Plani i mostrimit (për vitin pasardhës për secilin 3 mujor apo 6 mujor raportimi).

Komisioni sqaron, se bazuar në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, në nenin 1 dhe 2 “Qëllimi dhe Objekti”, parashikohet shprehimisht: “*Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës*”. Ky ligj përcakton: a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë; b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.” Ndërsa në nenin 4 “Sistemi i lejeve të mjedisit” të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “1. Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë: a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/A të këtij ligji; b) leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë

përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji; c) leja e mjedisit e tipit C është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë C, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/C të këtij ligji.”

Nga analizimi i dokumenteve të tenderit në shtojcën 5 “specifikimet teknike” mungon plani i mostrimit (për vitin aktual ushtrimor, për secilin 3 mujor apo 6 mujor raportimi), që është një ndër dokumentet që duhet të dorëzohet nga subjektet e pajisura me leje mjedisi të tipit A ose B, bazuar në urdhrin nr. 126, datë 10.06.2022, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit “Për procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumenteve dhe raporteve të vetëmonitorimit, për subjektet e pajisur me leje Mjedisit të tipit A ose B”.

Sa më sipër, rezulton se qëllimi i plotësimit të kushteve të përcaktuara në aneksin 1 të urdhrin nr. 126, datë 10.06.2022 është për operatorët e pajisur me leje mjedisi, të cilët duhet të dorëzojnë këto dokumente mbi zbatimin e kushteve të lejes mjedisore, ndërkohë referuar shtojcës 5 “Specifikimet teknike”, rezulton, se mungon plani i mostrimit, një ndër dokumentet që duhet dorëzuar në zbatim të urdhrin të sipërpërmendur, duke mos i shërbyer në këtë mënyrë qëllimit, që është monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumentar të tenderit, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe i specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës objekt prokurimi. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor nuk i ka hartuar dokumentet e tenderit në përputhje me ligjin për prokurimin publik, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës objekt - prokurimi, pasi mungon një ndër dokumentet që duhet të dorëzohet në zbatim të urdhrin nr. 126, datë 10.06.2022, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentet e tenderit të mësipërm në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e veçanta për kualifikim, specifikimet teknike nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe t’i japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës.

III.1.7. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin”*; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: *“Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”*, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: *“[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se mospërputhja e krijuar midis kërkesave të parashikuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 5 “Specifikime teknike”, si dhe përcaktimet e bëra në Urdhrin nr. 126, datë 10.06.2022 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, “Për procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumenteve dhe raporteve të vetëmonitorimit, për subjektet e pajisura me leje mjedisi të tipit A ose B”, ndikon drejtpërdrejtë në hartimin e ofertës ekonomike të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe në vlerësimin e ofertave nga ana e KVO-së, si dhe është haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, ndaj përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë konstatimet e këtij vendimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK për skualifikimin e “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK dhe “Tenuis Laboratories” SHPK dhe “GR Albania” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi në procesin administrativ, për sa kohë që procedura e prokurimit do të anulohet pas arsytimit më sipër të KPP-së, duke përmbushur edhe interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 115 pika 1 dhe 3, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e

Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Qendra e Monitorimit të Mjedisit" SHPK në procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur e thjeshtuar – shërbime, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me një ose më shumë operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF- 81675-09-28-2023, me objekt: Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore”, Loti I: REF-81681-09-28-2023 me objekt Loti I : “Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore” (për landfillin) me fond limit 3.000.000 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 10.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria “ECO – ELB” SHA.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

